

Namik SELMANI

BESIMI MUSLIMAN NË FOLKLORIN E KRAHINËS SË ÇAMËRISË

Asnjë historian, demograf, sociolog, gjeograf, arkeolog, folklorist, gjuhëtar, që merr përsipër të qëmtojë në fushën e vet studimore për krahinën e Çamërisë nuk mund të anashkalojë kurrësesi faktin, aspak të diskutueshëm, të ndikimit të jashtëzakonshëm të besimit islam në jetën ekonomike, shoqërore, shpirtërore, të kësaj krahine që, të paktën në shekujt e fundit e sidomos në 100 vitet e fundit e ka patur dhe e ka (ndonëse me një popullsi tashmë të shpërngulur me forcë nga trojet e veta stërgjyshore këtë besim si identitet dhe si mbijetesë.

Ky vitalitet shpirtëror, ndër më të rrallët për forcën e tij në mbarë Ballkanin bashkë me atë të popullsisë së Kosovës, i mbështetur te ky besim njësohej me shumë fusha të jetës së popullsisë çame që në traditat zakonore, në ato ndërtimore, në guzhinën tradicionale, në onomastikën e pasur e aq të larmishme, në urimet e mallkimet, në dasmat e gëzimet, në ritet fetare që bëheshin aq të rregullta në tërë krahinën, në tolerancën fetare që tregonte kjo popullsi në lidhje me pjesën e popullsisë së krishterë që kishin shumë fshatra të Çamërisë.

Nuk është aspak befasi apo edhe rastësi që edhe krijimi i familjeve të reja, dashuritë e bukura njerëzore që tregonin një pjesë tjetër po kaq të bukur të shpirtit çam të kishte këtë lidhje kaq të harmonishme mes besimit islam dhe vetë jetës që gëlonte në viset e Jugut sa e bukur në atë traditë që zbukuronte jetën e secilit mysliman çam aq edhe të vështirë përballë manovrave, qëllimeve të shtetarëve grekë, të kishës greke për asimilimin e kësaj popullsie, për mohimin e të drejtave më themelore njerëzore,

atë të besimit e njohjes së gjuhës amtare që duhet të kishte një njeri. Brenda kufinjve të kësaj sfide të vërtetë jetësore në kohën që jenët (fëmijët) çamë hidhnin hapat e parë në tokën e bekuar të Çamërisë, nënat i faleshin Zotit me vargje të dala nga shpirti i tyre i bukur dhe i madh:

Shuqur, o i madhi Zot
Kjo ditë që më erdhi sot
Që më ecën kjo fëmilë
Zoti të ma lërë të mirë

Në xhamitë e shumta të Çamërisë (në fillim të shekullit XX, por edhe deri në vitet 40 të këtij shekulli, kishte dhe nga tre, katër në fshatra të ndryshëm) bëheshin jo vetë ritet fetare, por edhe kuvendet e shumta për probleme të ndryshme që kishte fshati. Në vitet 1913-1944 kur kjo krahinë u shkëput nga trugu amë, xhamitë e fshatrave shërbenin edhe si shkolla të mirëfillta shqipe, ku fëmijët bashkë me njohuritë për besimin islam, mësonin nga klerikët patriotë shqiptarë, herë haptaz e herë fshehurazi, shkronjat shqipe. Një gjë të tillë e mësojmë nga shumë banorë, burra dhe gra, që ende jetojnë në qytete të ndryshme të Shqipërisë që prej 64 vjetësh, por edhe nga shumë dokumenta të arkivave të kohës. Oborret e xhamive ktheheshin në mjedise festive të ngjarjeve të rëndësishme. Të tillë mund të përmendim datën 2 shtator 1941, kur në oborrin e Xhamisë së Paramithisë u mblodhën me qindra vetë për të ngritur flamurin shqiptar.

Paramëthi, moj Paramëthi
Tridhjet vjet nënë Greqi
.....
Paramëthi u ngrenë e vanë
Shkuan e vanë në xhami
Ngrenë flamurin kuq e zi

Në dekorin e fshatrave të Çamërisë xhamitë patjetër ishin institucione më të respektuara të besimit, të bashkimit, të këngës, të pajtimit, të respektit ndaj njëri-tjetrit. Vetëm në fshatim Mazrek ka pasur 4 xhami: ajo e Kovaçëve, e Çapuratëve, e Kolicatëve dhe

e Mahalesë. Sipas tregimit të Refik Pronjos dhe Riza Kalit nga Paramithia, ky qytet, që në vitet 1944- 1945 do të jetonte tmerrin më të madh të genocidit grek, kishte 8 xhami me rëndësi jo vetëm për këtë qendër të banuar, por dhe për mbarë Çamërinë. Të tilla mund të përmendim Xhaminë e Kalasë (ishte brenda në kalanë e qytetit), të Kanelës, të Bollatëve, të Këndalit, të Qendrës (në të dikur ishte falur Sulltan Bajaziti), të Pazarit, të Prronjatëve, të Shardhaqes. Në fshatin Margëllëç kishte 5 xhami. Vetëm në Janinë, ku banonin rreth 40 000 banorë kishte 30 xhami, disa medrese që përgatisnin klerikë për fshatrat muslimane të Çamërisë. Në qytetin e Konispolit ka patur 5 xhami: e Aliagatit në qendër, e Çuçatit, e Llanxatit, e Pashanjet dhe e Shehatit.

Sheshet e xhamive që ishin kryesisht në mes të fshatrave çame ktheheshin në kuvende dhe për ngjarje të rëndësishme. E tillë është edhe kënga e krijuar në Galbaq të Filatit:

Mu ne Sheshi i Xhamisë
Treqind burra të Labërisë
U thirrën si për mexhliis

Edhe pse organizimi administrativ i fshatrave të krahinës bëhej kryesisht me kryepleqtë e fshatrave që edhe mund të grumbullonin fonde për ndërtimin e xhamive në fshatra, nuk janë të pakta rastet, kur familje apo fise të caktuara, ndërtonin xhami të reja me kursimet e tyre. Këto xhami më vonë do të mbanin simbolikisht emrat e fiseve, por që do të ishin gjithmonë dyerhapura për të gjithë besimtarët e tjerë. Kështu mund të përmendim Xhaminë e Llodozave në Koskë, të Sejkatëve në Filat, Xhaminë e Ali Çubit në Margëllëç etj

Po të shikojmë një këngë tepër të veçantë në grupin e këngëve me ndikimin te besimi islam na bëjnë përshtypje tre vargje ;

“ Sollopia Medine

Me treqind e ca hane
Dhe me treqind plorë dhe

Ky krahasim i këtij fshati me qytetin e shenjtë të Medinës në Arabinë Saudite ka lindur nga një gojëdhënë që flet për bujarinë

e fshatarëve të tij. Një djalë nga Sollopia dhe një djalë turk bënë shërbimin ushtarak në një vend të largët. Miqësinë e tyre të madhe ata e çuan deri në vëllamëri. Që t' u dilte përpara halleve të pafundme, një ditë sollopioti i dërgoi kartë turkut se “ në fshatin e tij kishte rënë një zi buke”. Me të marrë këtë letër turku i dërgon 500 mushka me grurë duke iu thënë kalorësve që t' i çonin në “ Sollopinë Medine”

Këngët e trimërisë në pamje të parë nuk zënë ndonjë vend të madh në numër përmbri këngëve lirike në këtë krahinë. Por ato nuk janë më pak të fuqishme në mesazhin që sjellin dhe në forcën artistike që përcjellin te lexuesi i të gjithë kohërave. Motivi atdhetar në këngët e tilla shkrihet aq harmonishëm me elementë fetarë të besimit tek Zoti. Është mesazhi i fuqishëm atdhetar i shqiptarëve se “pa fe nuk ka adhe”. Ky del si asnjëherë më i qartë dhe i plotë në këngën “Osman Pashë trimëria” të kënduar në Arpicë që ka edhe një fillim simbolik

Allah , të biç(bësh) bejan
Ashtu si na ndodhi vakija
Ç'ish nglau në këtë zeman
Osman Pashë trimëria

Një ngjarje epike e ndodhur në kohën e rezistencës së kësaj popullsie kundër forcave të Ali Pashës që donte të pushtonte Çamërinë, na ka lënë një trashëgim të bukur folklorik. Xhafo Dhërmica nga fshati Dhërmicë i Gumenicës ishte një trim që s' e njihte vdekjen. Por pabesia e armiqve kaq e madhe sa atë vendosën që ta sulmonin kur ai falte **namazin e suhurit**. Edhe pse me rrobat e faljes, ai mori armën e filloi luftën. Kërkoji të çante rrethimin, pasi vrau shumë armiq, por nuk mundi dot.

Dërgon Ali Pashai
Të ziret Xhavo qerratai
Në Dhërmicë e bë berhai
Që n' suhur jaram në drekë
Luftoi Xhavua me brekë
Aq sa kishte fishëkë

Kënga poullore çame mori përsipër që të përjetësonte dhe kujtimin e vyer të klerikëve muslimanë të kësaj krahine që ishin jo vetëm udhëheqës të besimit shpirtëror të krahinës së tyre, por edhe luftëtarë të shquar të çështjes kombëtare. Të tillë mund të përmendim Hoxhë Memenë si quhej shkurt në kujtesën popullore Myftiu i Filatit Hoxhë Mehmet Zeqiraji, Dëshmor i Kombit që u vra nga grekët më 1941.

Ki Hoxhë Memeja
Qëlloi me dilbi
Ndëra e këtej nndëra
U bë Shqipëri.

Natyrisht në këtë thesar folklorik nuk mund të mungonte edhe kënga për dijetarin dhe teologun e shquar Hasan Tahsini. Me pak fjalë të kursyera populli bën portretin e tij

Dijetar Hasan Tahsini
Në tufane çan shahini
Atdhetar, bir atdhetari
Sadrazemi, shehislami
Mëndjendritur, zëmërtrimi

Kënga popullore bëhet edhe pjesë e dhimbjes së madhe që edhe këtu merr forcë në besimin te Zoti. Pas masakrave të vitit 1945 që kishin një parapavijë të qartë të një lufte edhe me nuanca fetare kënga thotë:

Raçë në gjumë me pikëlli
Mos më keq, moj Perëndi
Pashë një ëndërr llahatari

Ose në një këngë tjetër që ka po këtë temë me një qartësi të madhe këngëtari popullor thotë:

Si na e bëri ne Greqia
E pa vetë Perëndia

Mbilli burrat në shtëpi
I theri si bagëdi

Optikës së folklorit nuk i shpëton edhe protesta ndaj vëllavrasjes që bëhej jo vetëm në planin atdhetar, por edhe si pjesë e besimit të Zotit që nuk lejon të krijosh hakmarrje në popullin tënd.

Ditën e Bajramit seç erdhën e të thanë
Nur babaselimi, nur të qofshim falë
.....
Erdhën melaqetë e të prunë selamnë
T'u bë kabull lutja po bën teslim xhanë

Morali isalm në shumë këngë del i plotë në këngë të mirëfillta fetare. Mjafton të lexosh disa prej tyre e të shohësh jo vetëm këshillat e vyera të islamit por edhe aftësinë artistike që kishte populli për trajtimin e kësaj teme aq interesante. Në një këngë të kënduar në fshatin Galbaq të Filatit thuhet ndër të tjera

Bënu hoxhë e vesh një gunë
Falu ditën pesë herë
Për nonjë mos fol rrerë
Se do vemi në atë jetë
N'atë jetë të vërtetë.

Sipas zakoni të bukur të famljeve çame kur dilte gruaja në mëngjes dhe hapte derën e saj bënte lutjen e zakonshme që thuhet në këto vargje:

Bismilah rrahmani rrahim
Ditë e re kismet i ri
Hiftë fati në shtëpi.

Kjo këngë ose më saktë ky ritual fetar ngjan me ajetin kuranor ku thuhet "Pasha këtë mëngjes!"

Nuk janë të pakta edhe këngët, kur burrat ose gratë vendosen në veprime që tregojnë se ata janë besmtarë të devotshëm . Në një këngë- dialog të fëmijëve me hënën, ajo tregon se e ka parë babain

e tyre “ duke marrë avdes me ibrik të argjendë në Prevezë”

Hënë , hënë , kako hënë
As na pe babanë tënë?
-Në Prevezë e pashë prëmë
mirr avdes me brik t’argjendë.

Edhe në yshtjet që bënin ndonjë herë gratë –nëna për fëmijët e tyre të sëmurë, kërkohet gjithmonë ndihmë te Zoti. Një nënë nga Grikohori i Gumenicës kur fëmija i saj kishte këputur mish, recitonte këto vargje:

O zot i vërtetë
Xerre në selamet
Këtë rop që ka kput mish
Vënia mishin neku ish
I itat, i im atë
I it gjish
Vëria misht atje nek ish.

Në pamundësi për të patur libra të historisë islame vetë kënga merr misionin e madh edhe të njohjes së kësaj historie , të zbërthimit të shumë ajeteve e sureve me poezi

Atë jetë është një urë
Kush të shkojë është burrë
Urdhëroi vetë xhelili
Korbanë bëri Ismaili
.....
Gjunahqarët i kërdisi
Brenda në xhehnm i vulisi(futi)

Besimtari çam nga Margëllëçi para së të vërë kokën në jastëk për gjumin e natës bashkë me faljen e tij këndon edhe këto vargje:

Zot i madh, të klofshim falë
Bëra nijet të kumbisem të fle
Bëra veqil milaqetë

Të më dijnë(ndihmojnë) këtë natë sonte
Në u difsha ishalla
Në s' u difsha embër allah.

Brenda kësaj hapësire të gjërë shpirtërore që të jep besimi tek
Zoti e profetët e dërguar prej tij, këngëtari popullor nuk harron të
njësojë veten edhe si çam

Lah, ilah e jarabi
Vetëhenë çam e di
Nanë e babë çam e di
Vëllezër e motra çamë e di
Gjithë arnautllëkun arnaut e di.

Muaji i Madhnueshëm i Ramazanit që sjell edhe ditën e bekuar
të Bajramit e ka nxitur këngëtarin popullor nga Vola që të këndojë
me nderim:

Këto ditët e Remazanit
Jan t'afruarat e Bajramit
Kush agjëron kët Remazan
Isht i afruar për Bajram.

Ky gëzim na del po kaq i madh një këngë tjetër kur flitet për
festën e bekuar të Bajramit. Edhe familja më e varfër në krahasim
me të tjerat në fshatrat myslimane e mbushte atë ditë sofrën plot .
Urimet përcillnin njëri-tjetrin e begatia mbushte pragjet:

Tepsia me bakllai
Për shumë mot Bajramin e ri
Bajramin ç'e kemi sot
Kutu kemi plaka plot.

Është pikërisht kjo festë që në një moment tjetër ka edhe
trishtimin që të sjell kurbeti, vajtja nizam e burrave. Monologu i
një gruaje që e respekton ditën e Bajramit, në të cilën ka prerë edhe
një fustan të ri, shoqërohet me dhimbjen e saj që nuk e ka burrin
pranë e të gëzojë familjarisht me të .

Ditën e Bajramit
 Preva një fustan
 Mjera u e mjera
 Me çil do ta mbaj
 Një burrë që kështa
 Ma muarrë nizam
 Më dërgoi një kartë
 Më dërgoi selam
 I marrça të keqen
 Iu bëfsha kurban

Po të shohësh me vemendje hyrjet e shumë këngëve, pavarësisht nga karakteri i tyre epik ose lirik ato fillojnë me ditën e xhuma (të premten) që është një nga ditët më të shënuara për myslimanët. Në këngën “ M’u prët këmbët, m’u pretë “, kënga nis kështu: M’u pretë këmë, m’u pretë / Atë ditën e xhumasë. Në këngën “ Të xhumanë në qindi” është po kjo hyrje ,veç me një ndryshim se është në fillim të këngës :

Të Xhumanë në qindi
 Në Volë u bë një thjamë(fatkeqësi, mandatë)

Në këngën kushtuar vrasjes së patriotit Mulla Qemal Dautit kënga nis kështu:

Të xhuma më të xhuma
 Mulla Qemali u vra.....

Qetësia shpirtërore e muslimanit aq e pranishme në situata të vështira të jetës, kthehet në vargjet e këngës në një burim qetësie, në një forcë për kapërcimin e tyre .

Buza thotë:” S’ka të folë
 As kur leni mos gëzoni
 As kur vdisni, mos helmoni.
 Hapni dyert xhenetit
 Janë fekse(dritë) e llambadhë
 Hapim dert e xhehenemit

Ishtë pisë e dhe skotarë

Fakti që morali islam është i shkrirë në masën më të plotë në këngën popullore çame, tregon atë përhapje të natyrshme, atë klimë masive besimi që ishte në secilën familje. Për ta bërë këtë moral të njohur edhe te më të rinjtë në to predikohet ndershmëria në luftë me ata që bëjnë gjynahe. Pranohet bota tjetër (ahireti), për të cilin secili besimtar duhet të punojë që në këtë jetë. Predikohet dashuria për njëri-tjetrin, dashuria e respekti për fqinjin (gjtonin) dhe kritikohet veprimi i mynafikëve:

Në atë jetë që do vemi
Është gjarpëri sa demi
Ai njeri që s' do njerinë
D'e djegin si qirinë
Jitoni që s' do jitonë
Me kran d'e përvëlojnë
Mynafik vatan mos pastë
Brenda varri mos e dhekstë.

Nëse do ta shikonim nga plani gjuhësor dhe artistik në këto këngë të bëjnë përshtypje detajet artistike që zgjedh poeti popullor. Kontraste mbresëlënëse pa rënë në një moral të thjeshtë ku jo rrallë bien këngë të tilla të krahinave të tjera.

Shkon ky urim e kjo frymë edhe në këngët e dasmës, sidomos në ditën kur në shtëpinë ku bëhet dasma vjen nusja

Bismilahi, rrahmani rrahim
Elhamdu liledhine
Nimeti xhelil
Beriqeti halil
Allahu mezi
Sufra sahibi
Zoti të na fali
Të trashëgohet djali

Mbarësia e nuses që niset nga shtëpia e saj për të shkuar te shtëpia e dhëndërrit nuk mund të kuptohet pa bekimin e Zotit,

ndaj dhe kënga e nënës, e shoqes, e motrës, e babait thotë:

Dolle, nuse dolle, me kokën mënjanë
Të përcolli nana të tha: “Udhë të mbarë!”
Kur më dolle derën, me paraponi
Kur më more udhën me bismilahi.

Në kulmin e gëzimit të festës një dialog i nuses me dhëndërrin i mbushur me epitete nga më të bukurit i ngroh të dy shpirtërat. Përballë bukurisë së vashës dhëndërrin pyet : “Vetullat përse t’u nxinë?/ sikur ke vënë mazinë?/Dhe vajza besimtare, por dhe shumë e zgjuar thotë thjesht: “ Jo, mor jo, për perëndinë / ma dha Zoti bukurinë.”

Një djalë tjetër dashuruar pas Refinanit mezi e pret Bajramin se pas dy javësh të Ramazanit do të shkojë në dyqan për të prerë një fustan të ri për të.

Në di javë Remazan
E bukura Refinan
U do vete në duqan
Të pshonis një top indian
Që të presësh një fustan
Ta kesh lule për bajram.

Gëzimi masiv i dasmës njësohet shumë herë me grumbullimin festiv të njerëzve në ditët e bajrameve, kur me rroba të reja, me urimet e pafund për njëri-tjertin në buzë dhe me falenderimet për Allahun e madhëruar, formojnë një dekor të bukur njerëzor në fshatrat e Çamërisë. Për këtë në fshatin Kurtës këndohet kështu:

Bajram, e ç’ish sot
Kutu janë zonjat lot
Bij t’i sho e s’i sho dot
M’u mbushën sitë me lot.

Kjo bëhet edhe kur këndohet duaja e bukës. Pasi hanë bukë, të gjithë pjesëtarët e sofrës këndojnë:

Zoti e shtoftë

Dhe e buroftë
Më shumë mo' ka sot

Ose në një këngë tjetër që këndohej në Picas të Filatit thuhej :
“Shtojë o zot, mbushe plot merrja agait/ jepja fukarait”. Vetëm besimi te zoti, te forca e tij e madhe mund ta bëjë edhe më të ndjerë këngën e dashurisë . Përballë një realiteti frymëzues. përpara portretit të vajzës së bukur që del e fshihet në dritare diku nën rrezet e bukura të hënës urimi “ të lëftë perëndia “ është më se i goditur për të shprehur atë gaz të brendshëm që i ka ardhur:

Del hëna ka mali
Llamburit shtëpia
Ja s’del në penxhere
Të lëftë Perëndia

Edhe toponimet e shumë fshatrave lidhen me besimin te Zoti. Ato janë subjekte të fuqishëm që tregojnë një vitalitet të madh shpirtëror. Në fshatin Pleshavicë, që është në afërsi të kufirit më Konispolin është një shpellë që quhet Shpella e Ujthit. Tregojnë për të një legjendë se si atje shkoi një grua për të lindur. Bëri një vrimë nga lart dhe lidhi tërkuzën. U lidh me të në hava që të lindëte kollaj Guri nën të u kthye në govatë që të lahej kur të lindtëte Por s’kishte ujë . Aherë ajo ngriti të dy duart përpjetë. I mbështeti ato në faqe të shpellës dhe iu lut Zotit: “ O Zot , më jep ujë!” Menjëherë lutja iu pranua. Atje ku ajo kishte vënë duart, uji buroi më bollëk. Me vite të tjera më pas shumë njerëz besonin se këtu është vend i mirë dhe shkojnë të lahen me këtë ujë që ata e quajnë “ujë të mirë” dhe shpellës ia vunë emrin “ Shpella e Ujthit”.

Një gojëdhënë shumë origjinale është dhe ajo e lejlekëve që e kanë drejtimin e vajtjes së tyre në vendet e ngrohta ku gjendet edhe Meka. Kërcëllitja e sqepave të tyre sipas besimtarëve të kësaj krahine duket si ezan (thirrje) dhe simbolika e vajtjes së tyre i ngjan asaj të haxhilerëve për në Mekë:

Haxhi lelek
Eja në xhami
Nëse do kati

Efendi me flutura.

Edhe onomastika e emrave të njerëzve të kësaj krahine ishte në shumicën e rasteve me origjinë fetare . Kështu emrat Ibrahim, Ismalil, Fatime, Haxhi , Rexhep, Jasin, Ajet, Ali, Adem, Hava, Nuh, Mustafa, Muhamet, Kadri, Bajram, Kadrie, që kanë origjinë islame i gjen edhe sot e kësaj dite në çdo shtëpi të fshatrave të Çamërisë.

Përballë kësaj galerie të vërtetë shumëngjyrëshe me tinguj, figura të pasura letrare shumë origjinale, hapësirë, dritë të fortë besimi me shpresën te Zoti që gjithësesi edhe brenda kuadrit të një eseje të plotë, mbetet akoma i virgjër dhe jo i rrahur plotësisht, historia e re nuk e ka mpakur këtë besim te fëmijët, nipërit e stërnipërit e atyre burrave e grave të kësaj krahine me një histori të lavdishme në drejtim të përhapjes së fesë islame. Në të gjitha vitet e qëndrimit në Shqipëri ku është pjesa më e madhe e të dëbuarve nga trojet e tyre, por edhe në vendet e tjera ku jetojnë e punojnë, asnjëherë nuk e patën pengun e përcjelljes së besimit te brezat më të rinj. Por, për fat të keq, në trojet tona amtare në të 70 fshatrat prej nga u dëbuan dhe u masakruan me mijëra njerëz të pafajshëm, objektet e kultit islam në Çamëri një nga një po zhduken . Natyrisht nuk bëhet fjalë për t'i ringritur dhe restauruar në gjendjen e mëparshme, nëse atje nuk do të skojnë banorët shekullorë të tyre. Jo, as që mund të mendohet një gjë e tillë. Sipas dokumenteve që janë të qarta shumë xhami po prishen duke gjetur një " argument" të fortë të ndërtimit të objekteve publike , sidomos të ndërtimit të rrugëve, të ndërtesave të tjera publike , me qëllim që të dobësohet ai besim i madh i popullsisë së Çamërisë që ka qenë shenjë e jetës dhe e indentitetit tonë kombëtar.

Bibliografia:

- * Rrapaj, Fatos -" Rënkimet e Çamërisë - Tiranë , 1985.
- Shabani, Halil- " Shalësi ynë në jug"- "Saranda", 1999.
- * Rrapaj, Mero Fatos- " Fjalori onomastik i Epirit" - Tiranë, 1995.